



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1579/ Prot.

Koplik, me: 30/06/2025

V E N D I M

Nr. 19 date 30 / 06 / 2025

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PARE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM (FPT) 2026-2028

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 30/06/2025 shqyrtoi projektin e pare të programit buxhetor afatmesem 2026 – 2028 (FPT) të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në nenin 34 dhe 41, të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr.9936 datë 26.6.2008”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar në ligjin nr.10296 datë 8.7.2010 ” Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, të ndryshuar , në udhezimin nr.23 datë 30.07.2018 ” Për Procedurata Standarte të Pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesem të njëjësive të vetë qeverisjes vendore” në ligjin nr.115/2024 Për Buxhetin e Shtetit te vitit 2025, udhezimin nr.8 datë 28/02/2025”Për Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026 – 2028”,

V E N D O S I

1. Miratimin e projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (FPT) sipas tabelave bashkëngjitur, dhe relacionin e PBA-së.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 30.06.2025

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.06.2025

